

Помирувачот и арбитерот се должни по еден примерок од склучена спогодба за решавање на колективен спор, односно за донесено решение за индивидуален спор да достават до министерството надлежно за работите од областа на трудот, во рок од пет работни дена од денот на склучувањето на спогодбата, односно донесувањето на решението."

Член 39

Поднасловот на членот 51 и членот 51 се бришат.

Член 40

Во членот 52 зборот "Советот" се заменува со зборовите: "Министерството надлежно за работите од областа на трудот".

Член 41

Министерот надлежен за работите од областа на трудот ќе ја донесе Програмата за обука за помирувачи и арбитри, во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Подзаконскиот акт за формата и содржината на лиценцата, како и начинот на нејзиното издавање од членот 37 став 4 од овој закон, министерот надлежен за работите од областа на трудот ќе го донесе во рок од 60 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Тарифникот за надоместокот на помирувачот и арбитерот од членот 14 став 2 од овој закон, министерот надлежен за работите од областа на трудот ќе го донесе во рок од 60 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон."

Член 42

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецизен текст на Законот за мирно решавање на работните спорови.

Член 43

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, а ќе започне да се применува од 1 јануари 2015 година.

L I G J

PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR ZGJIDHJE PAQËSISHT TË KONTESTEVE TË PUNËS

Neni 1

Në Ligjin për zgjidhje paqësisht të kontesteve të punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 87/2007), në nenin 1 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

"Kontestet individuale të punës mund të zgjidhen edhe në pajtim me Ligjin për ndërmjetësim."

Neni 2

Në nenin 3 paragrafi 1 fjalët: "me e ulët" shlyhen.

Neni 3

Në nenin 4 shtohen dy paragrafë të rinj 1 dhe 2, si vijojnë:

"Pajtim është pjesëmarrja e personit të tretë neutral në ndërmjetësim ndërmjet dy palëve kundërshtarë, me qëllim arritjen e marrëveshjes për zgjidhjen paqësisht të kontestit kolektiv.

Arbitrazh është pjesëmarrja e palës së tretë të pavarur në zgjidhjen e kontestit individual, me qëllim arritjen e zgjidhjes obliguese për lëndën e kontestit."

Paragrafët 1 dhe 2 bëhen paragrafë 3 dhe 4.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:
"Palët në kontestin kolektiv ose individual janë të lira që vullnetarisht të vendosin për qasje në zgjidhje paqësore të kontestit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe."

Neni 5

Në titullin para nenit 6 fjala "tripartizmi" zëvendësohet me fjalën "pavarësisë".

Neni 6

Në nenin 6 paragrafi 2 pas fjalës "vepron" shtohet fjala "pavarur".

Neni 7

Në titullin e Kreut II fjalët "Këshilli Republikan" zëvendësohen me fjalën "Procedura".

Para nenit 7 nëntitulli shlyhet.

Neni 8

Neni 7 ndryshohet si vijon:
"Zgjidhjen paqësore të kontesteve kolektive dhe individuale me rastin e prishjes së marrëveshjes për punësim dhe mospagimit të pagës e kryejnë pajtues dhe arbitra, me kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj."

Neni 9

Neni 8 ndryshohet si vijon:
"Punët profesionale administrative në lidhje me zgjidhjen paqësisht të kontesteve kolektive dhe individuale me rastin e prishjes së marrëveshjes për punësim dhe mospagimit të pagës i kryen ministria kompetente për çështje nga sfera e punës.

Ministria kompetente për çështje nga sfera e punës i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- mbajtjen e Regjistrit të pajtuesve dhe arbitrave (në tekstin e mëposhtëm: Regjistri),
- trajnim dhe ngritje profesionale të pajtuesve dhe arbitrave,

- përjashtim të pajtuesve dhe arbitrave,
- procedurë për lëshimin dhe heqjen e licencave të pajtuesve dhe arbitrave, në pajtim me këtë ligj,

- mbajtje të procedurës për zgjidhjen paqësisht të kontesteve të punës,

- evidencë të procedurave për zgjidhje paqësisht të kontesteve të punës dhe

- punë tjera të parapara me ligj.

Lëshimin dhe heqjen e licencave e kryen ministria kompetente për çështje nga sfera e punës, me propozim të Komisionit Trepalësh, formuar nga Këshilli Ekonomik Social, me përfaqësuesit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, nga shoqata reprezentative të punëdhënësve nga sindikata reprezentative."

Neni 10

Nëntitulli para nenit 9 dhe neni 9 shlyhen.

Neni 11

Titulli i Kreut III dhe nëntitulli "Dispozita të përbashkëta" para nenit 10 shlyhen.

Neni 12

Në nenin 10 paragrafi 1 fjalët në fund të fjalisë: "te Këshilli" zëvendësohen me fjalët: "me shkrim në ministrinë kompetente për çështje nga sfera e punës".

Neni 13

Në nenin 11 paragrafi 1 fjala "Këshilli" zëvendësohet me fjalët: "ministria kompetente për çështje nga sfera e punës", kurse fjala "tre" zëvendësohet me fjalët: "pesë ditë punë".

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Nëse në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, ministria kompetente për çështje nga sfera e punës nuk merr përgjigje për pranimin e propozimit për zgjidhjen paqësore të kontestit nga pala tjetër, do të konsiderohet se propozimi për ngritjen e procedurës nuk është pranuar."

Neni 14

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Pajturesin, respektivisht arbitrin me marrëveshje i përcaktojnë palët në kontest nga Regjistri, në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimit të propozimit për zgjidhjen paqësore të kontestit të punës.

Nëse palët në kontest me marrëveshje nuk përcaktojnë pajtues, respektivisht arbitër, e përcakton ministria kompetente për çështje nga sfera e punës nga Regjistri."

Neni 15

Në nenin 13 fjala "Këshilli" zëvendësohen me fjalët: "Ministria kompetente për çështje nga sfera e punës".

Neni 16

Titulli para nenit 14 dhe neni 14 ndryshojnë si vijojnë:
"Kompensimi për pajtues, respektivisht arbitër

Neni 14

"Pajturesi, respektivisht arbitri, kanë të drejtë kompensimi në lidhje me zgjidhjen paqësore të kontestit kolektiv, respektivisht individual.

Kompensimi nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohet me Tarifë, që e miraton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës.

Kompensimi për pajturesin, respektivisht arbitrin, është në llogari të ministrisë kompetente për çështje nga sfera e punës.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë."

Neni 17

Në nëntitullin para nenit 16 pas fjalës: " në" shtohen fjalët: "procesin e".

Neni 16 ndryshohet si vijon:

"Palët në marrëveshje kolektive (në tekstin e më poshtëm: palët), mund të paraqesin propozim në ministrinë përkatëse për çështje nga sfera e punës për pjesëmarrje të pajturesit në procesin e marrëveshjes kolektive sipas nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe parandalimit të krijimit të kontestit.

Palët mund të paraqesin propozim bashkërisht ose individualisht.

Nëse propozimin e ka parashtruar njëra nga palët, ministria përkatëse për çështje nga sfera e punës e dorëzon propozimin dhe dokumentacionin të pjesëmarrësit tjerë, me kërkesë që në afat prej pesë ditësh pune të prononcohen nëse e pranojnë pjesëmarrjen e pajturesit në procesin e marrëveshjes kolektive.

Propozimi i përmban: llojin e marrëveshjes kolektive për të cilën negociohet, palët, vendin dhe kohën e negociatave, dhe emrin dhe mbiemrin e pajturesit të përcaktuar të përbashkët.

Pajturesi në procesin e marrëveshjes kolektive:

1) merr pjesë në të gjitha fazat e procesit të marrëveshjes kolektive;

2) u sugjeron palëve të propozimeve që nuk janë në pajtim me ligjin dhe dispozitat tjera;

3) u jep ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër palëve dhe

4) u ndihmon palëve të arrijnë marrëveshje, pa të drejtë të imponojë zgjidhje.

Pajturesi është i obliguar të jetë neutral dhe i paanshëm gjatë negociatave."

Neni 18

Para nenit 17 shtohet nëntitull i ri si vijon: "Pjesëmarrja e pajturesit në kontestin kolektiv".

Neni 19

Neni 17 ndryshohet si vijon:

"Palët e marrëveshjes kolektive", sipas nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, mund të paraqesin propozim në ministrinë kompetente për çështje nga sfera e punës për pjesëmarrje të pajturesit, për ofrim të ndihmës për zgjidhjen e kontestit.

Pajturesi në procedurë të pajtimit gjatë kontestit kolektiv:

1) u ndihmon palëve të gjejnë zgjidhje të përbashkët për zgjidhjen e kontestit;

2) u sugjeron palëve për propozimet që nuk janë në pajtim me ligjet dhe dispozitat tjera;

3) u ofron ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër palëve në mënyrë të pavarur, neutrale dhe të paanshme dhe

4) u ndihmon palëve të arrijnë marrëveshje, pa të drejtë të imponojë zgjidhje në kontest, në pajtim me principet për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës."

Neni 20

Nëntitulli para nenit 18 zëvendësohet me nëntitull të ri si vijon: "Pjesëmarrja e pajturesit në konteste në veprimtaritë me interes të përgjithshëm".

Neni 21

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Në rast greve ose kontesti në veprimtari me interes të përgjithshëm ose në veprimtari në të cilat ndërprerja e punës do mund ta rrezikojë jetën ose shëndetin e njerëzve ose të shkaktojë dëm në përmasa më të mëdha, palët në kontest janë të obliguara që menjëherë të qasen drejt zgjidhjes paqësore të kontestit kolektiv.

Procedura për zgjidhje paqësore të kontestit kolektiv nga paragrafi 1 i këtij neni, mbaron në afat prej dhjetë ditësh nga parashtrimi i propozimit për zgjidhje paqësore të kontestit.

Veprimtari sipas paragrafit 1 të këtij neni, janë veprimtaritë që i kryejnë punëdhënësit në sferën e: elektroekonomisë, ekonomisë së ujërave, komunikacionit, radiotelevizionit themelues i të cilit është Republika e Maqedonisë ose njësitë e vetëqeverisjes lokale, shërbimeve postare, veprimtarive komunale, prodhimit të produkteve themelore ushqyese, mbrojtjes shëndetësore dhe veterinarë, arsimit, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes sociale, policisë dhe mbrojtjes.

Në rast greve në veprimtaritë nga paragrafi 3 i këtij neni, për kohëzgjatjen e procedurës për zgjidhje paqësore të kontestit nga paragrafi 2 të këtij neni, greva është në pezullim."

Neni 22

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Në veprimtaritë nga neni 18 i këtij ligji, palët në kontest janë të obliguara që të paraqesin propozim të përbashkët për pajtim në ditën e ardhshme nga dita e ndodhjes së kontestit.

Nëse palët e kontestit nuk paraqesin propozim të përbashkët, janë të obliguara që ta njoftojë ministrinë përkatëse për punët nga sfera e punës, e cila në afat prej dy ditësh nga dita e ndodhjes së kontestit ose grevës në veprimtaritë nga neni 18 i këtij ligji, me detyrë zyrtare ngrit procedurë për barazim dhe cakton pajtues nga Regjistri.

Pajturesi është i obliguar që ta fillojë procedurën për zgjidhje paqësore të kontestit, në ditën e ardhshme nga dita e pranimit të propozimit dhe dokumentacionit për lëndën e kontestit dhe për këtë t'i njoftojë palët në kontest."

Neni 23

Në nenin 20 paragrafi 2 fjalët: "një përfaqësues" zëvendësohen me fjalët: "numër i barabartë i përfaqësuesve", kurse fjalët: "dhe pajtuesi" shlyhen.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Në procedurën për barazim merr pjesë edhe pajtuesi, pa të drejtë të vendimmarrjes."

Neni 24

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Në procedurë për pajtim, pajtuesi u ndihmon palëve që të vijnë në marrëveshje të përbashkët të pranueshme pa imponuar zgjidhje për kontestin.

Këshilli e mbyll debatin në afat prej 20 ditësh nga dita e hapjes së debatit dhe miraton rekomandim për mënyrën e zgjidhjes së kontestit (në tekstin e mëtejme: rekomandim)."

Neni 25

Në nenin 26 paragrafi 2 fjala "Këshilli" zëvendësohet me fjalët: "ministra kompetente për çështje nga sfera e punës".

Neni 26

Në nenin 27 pas fjalës "lidhin" shtohen fjalët: "ose nuk lidhin", kurse numri "30" zëvendësohet me numrin "20".

Neni 27

Neni 28 shlyhet.

Neni 28

Në nenin 29 paragrafi 1 pas fjalës "kontest" shtohen fjalët: "me pajtim të përbashkët të palëve në kontest".

Në paragrafin 1 pika 2 fjalët: "më e ulët" shlyhen.

Neni 29

Nenet 31 dhe 33 shlyhen.

Neni 30

Neni 37 ndryshohet si vijon:

"Pajtues, respektivisht arbitër, mund të jetë personi i cili ka marrë licencë nga ministria kompetente për çështje nga sfera e punës, me propozim të Komisionit nga neni 8 paragrafi 3 të këtij ligji.

Për marrjen e licencës nga paragrafi 1 i këtij neni, personi nevojitet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) të ketë përgatitje të lartë profesionale dhe së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e marrëdhënieve të punës;
- 3) të mos i jetë shqiptuar sanksion për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarie ose detyrës;
- 4) të jetë i denjë në detyrën pajtues, respektivisht arbitër dhe
- 5) të ketë certifikatë nga ministria kompetente për çështje nga sfera e punës për trajnim të kryer të suksesshëm, sipas Programit për trajnim të pajtuesve dhe arbitrave.

Licenca lëshohet në kohë të pacaktuar, kurse e njëjta hiqet me humbjen e cilësisë pajtues ose arbitër, në rastet e përcaktuara në nenin 31-a të këtij ligji.

Formën dhe përmbajtjen e licencës, si dhe mënyrën e lëshimit të saj me akt i përcakton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës.

Programin për trajnim të pajtuesve dhe arbitrave e miraton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës."

Neni 31

Nenet 38, 39, nëntitulli para nenit 40 dhe neni 40, nëntitulli para nenit 41 dhe neni 41 shlyhen.

Neni 32

Neni 42 ndryshohet si vijon:

"Regjistri i përmban të dhënat në vijim:

1) emrin dhe mbiemrin e pajtuesit, respektivisht arbitrit;

2) adresën;

3) përgatitjen profesionale;

4) numrin dhe datën e ndarjes së licencës;

5) numrin dhe datën e regjistrimit në Regjistër dhe

6) numrin dhe datën e shlyerjes në Regjistër.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga neni 8 paragrafi 2 alineja 1 të këtij ligji i përcakton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës."

Neni 33

Në nenin 43 fjalët: "paragrafi 2 pikat 2 dhe 4" zëvendësohen me fjalët: "pikat 1 dhe 2".

Neni 34

Neni 44 ndryshohet si vijon:

"Cilësia e pajtuesit dhe arbitrit pushon:

1) nëse në mënyrë plotësuese konstatohet se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 37 të këtij ligji;

2) nëse pushojnë së ekzistojnë kushtet nga neni 37 të këtij ligji;

3) nëse nuk vepron në pajtim me nenin 50 të këtij ligji;

4) nëse pa arsye nuk merr pjesë në procedurë për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës për të cilën është zgjedhur, respektivisht është përcaktuar;

5) nëse pa arsye e prolongon procedurën për zgjidhje paqësore të kontesteve të punëve ose procedurën nuk e mban në pajtim me ligjin;

6) me kërkesë të tij;

7) për shkak të humbjes së aftësisë së punës dhe

8) për shkak të vdekjes."

Neni 35

Nenet 45 dhe 46 shlyhen.

Neni 36

Në nenin 47 paragrafët 1, 2 dhe 3 fjalët: "drejtori i Këshillit" zëvendësohen me fjalët: "ministri kompetent për çështje nga sfera e punës".

Neni 37

Neni 49 shlyhet.

Neni 38

Neni 50 ndryshohet si vijon:

"Pajtuesi dhe arbitri, janë të obliguar ta njoftojnë ministrinë kompetente për çështje nga sfera e punës për ngritjen, rrjedhën dhe mbarimin e procedurës për zgjidhje paqësore të kontestit të punës.

Pajtuesi dhe arbitri, janë të obliguar që nga një ekzemplar nga marrëveshja e lidhur për zgjidhjen e kontestit kolektiv, respektivisht për aktvendim të miratuar për konteste individuale, të dorëzojë në ministrinë kompetente për çështje nga sfera e punës, në afat prej pesë ditësh pune nga dita e lidhjes së marrëveshjes, respektivisht miratimit të aktvendimit."

Neni 39

Nëntitulli i nenit 51 dhe neni 51 shlyhen.

Neni 40

Në nenin 52 fjala "Këshilli" zëvendësohet me fjalët: "Ministria kompetente për çështje nga sfera e punës".

Neni 41

Ministria kompetente për çështje nga sfera e punës, do ta miratojë Programin për trajnim të pajtuesve dhe arbitrave, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Aktin nënligjor për formën dhe përmbajtjen e licencës, si dhe mënyrën e lëshimit të tyre nga neni 37 paragrafi 4 të këtij ligji, ministri kompetent për çështje nga sfera e punës do ta miratojë në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Tarifën për kompensim të pajtuesit dhe arbitrit nga neni 14 paragrafi 2 të këtij ligji, ministri kompetent për çështje nga sfera e punës, do t'i miratojë në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 42

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për zgjidhje paqësisht të kontesteve të punës.

Neni 43

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“, e do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2015.

931.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

УКАЗ

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРОДАЖБА И ДАВАЊЕ ПОД ЗАКУП НА ДЕЛОВНИТЕ ЗГРАДИ И ДЕЛОВНИТЕ ПРОСТОРИИ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Се прогласува Законот за дополнување на Законот за продажба и давање под закуп на деловните згради и деловните простории на Република Македонија, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 3 февруари 2014 година.

Бр. 07-661/1
3 февруари 2014 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗАКОН

ЗА ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРОДАЖБА И ДАВАЊЕ ПОД ЗАКУП НА ДЕЛОВНИТЕ ЗГРАДИ И ДЕЛОВНИТЕ ПРОСТОРИИ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Член 1

Во Законот за продажба и давање под закуп на деловните згради и деловните простории на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 13/13 и 69/13), по членот 1 се додава нов член 1-а, кој гласи:

„Член 1-а

Одредбите на овој закон се применуваат и на деловен простор - спортски објекти над кои права, должности и одговорности во поглед на користењето, управувањето и располагањето има Република Македонија.“

Член 2

Одредбите на овој закон ќе се применуваат до 31 мај 2014 година.

Член 3

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHITJE DHE DHËNIE ME QIRA TË NDËRTEHAVE AFARISTE DHE HAPËSIRAVE AFARISTE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 1

Në Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 13/13 и 69/13), pas neni 1 shtohet neni 1-a, si vijon:

"Neni 1-a

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për hapësirë afariste - objekte sportive mbi të cilat të drejta, obligime dhe përgjegjësi në aspekt të shfrytëzimit, menaxhimit dhe disponimit ka Republika e Maqedonisë."

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen deri më 31 maj 2014.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

932.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

УКАЗ

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПОШТЕНСКИТЕ УСЛУГИ

Се прогласува Законот за изменување на Законот за поштенските услуги, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 3 февруари 2014 година.

Бр. 07 – 662/1
3 февруари 2014 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗАКОН

ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПОШТЕНСКИТЕ УСЛУГИ

Член 1

Во Законот за поштенските услуги („Службен весник на Република Македонија“ број 158/10), во членот 92 став (1) годината „2014“ се заменува со годината „2016“.

Член 2

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецистен текст на Законот за поштенските услуги.